



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2526, date 6.11.2014

Për

“Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Altelecom dhe vendosjen e masave rregulluese”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 6.11.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Altelecom dhe vendosjen e masave rregulluese”

mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Punes, të përbërë nga:

- i. Relacioni shpjegues;
- ii. Dokumenti *“Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakice i shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme - Dokumenti Përfundimtar”*;
- iii. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.
- iv. Komentet e palëve të interesuara.

BAZA LIGJORE:

- 1) Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
- 2) “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, ndryshuar me vendimin nr. 2342, date 31.07.2013, të Keshillit Drejtues të AKEP (**Rregullorja**).
- 3) Vendim nr.2492, date 23.07.2014, i Keshillit Drejtues të AKEP për “*Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakice te sherbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme-Këshillim Publik*”
- 4) Vendim Nr.2522, datë 6.11.2014, i Keshillit Drejtues të AKEP për “*Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakice i sherbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme - Dokumenti Përfundimtar”*”

KESHILLI DREJTUES

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

VEREN:

1. Bazuar në VKD nr.2120, datë 4.07.2012, të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, i ndryshuar, Eagle Mobile sh.a (aktualisht Albtelecom sh.a) është shpallur sipërmarrës me FNT në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Eagle Mobile (Albtelecom).
2. Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT sipas pikës 5 të VKD nr.2120, datë 4.07.2012 është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut te kryer sipas nenit 34 te Ligjit 9918.
3. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr.2492, date 23.07.2014, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakice te sherbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme-Këshillim Publik*”.
4. Këshillimi publik u krye më datë 25.07.2014-24.09.2014,, dhe Albtelecom nëpërmjet shkresës Nr. 9185 Prot, datë 24.09.2014, ka dërguar komente për dokumentin e Analizës, propozimet e AKEP për FNT dhe për masat rregulluese.
5. AKEP me VKD Nr.2522, datë 6.11.2014 ka miratuar dokumentin “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumice të terminimit dhe tregu me pakice i sherbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme - Dokumenti Përfundimtar*”, i cili përmban edhe qëndrimet ndaj komenteve të palëve të interesuara, përfshirë komentet e Albtelecom.

6. Dokumenti “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme - Dokumenti Përfundimtar*” i miratuar me VKD Nr.2522, datë 6.11.2014,
- përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - ka adresuar plotësisht çështjet e rekomanduara nga Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 303, datë 16.01.2014 dhe rekomandimet e rezolutës së Kuvendit nr 251/3 prot., datë 03.06.2014 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013" (sipas opinionit të AK);
 - përmban arsyetimin dhe përfundimin se Albtelecom sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Albtelecom si dhe përmban arsyetimin për masat rregulluese për FNT për terminimin e thirrjeve në rrjet celular.
 - detyrimet e vendosura për FNT të Albtelecom janë në përputhje me përcaktimet e nenit 36 të ligjit 9918 dhe bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe janë proporcionale e të justifikuara nga pikëpamja e objektivave rregullatore të vendosura në nenin 7 të ligjit 9918

A T E H E R E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij vendimi për konkurrencën në treg, sipërmarrësin dhe realizimin e objektivave rregullatore, , në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

- Bazuar në dokumentin “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme - Dokumenti Përfundimtar*”, miratuar me VKD Nr.2522, datë 6.11.2014, të përcaktojë sipërmarrësin Albtelecom Sh.a., sipërmarrës me FNT në tregun përkates:
 - tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm të Albtelecom.¹
- Sipërmarrësi Albtelecom sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT, për shërbimin e terminimit të thirrjeve, është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet përkatëse si më poshtë, por pa u kufizuar:
 - Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 të ligjit nr. 9918.*
 - Detyrimin e transparencës, sipas nenit 40 të ligjit nr. 9918.*
 - Detyrimi për ndarjen e llogarive, sipas nenit 41 të ligjit nr. 9918.*
 - Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, sipas nenit 42 të ligjit nr. 9918.*

¹ Përkufizimi i tregut përkatës është dhënë në dokumentin përfundimtar të analizës së tregut dhe statusi me FNT është për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare dhe fikse kombëtare.

2.5 Detyrimin per kontroll te tarifave dhe sistemin e mbajtjes se llogarive, sipas nenit 45 te ligjit nr. 9918.

3. Detyrimet e mësipërme në pikën 3, përfshijnë midis të tjerave:

3.1 **Detyrimi i Mosdiskriminimit:**

- i) Sipërmarrësi Altelecom Sh.a., të zbatoje kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t'u ofroje sipërmarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikundër ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij
- ii) Sipërmarrësi Altelecom Sh.a., të përditësoje Ofertën Referencë të Interkoneksionit, për ta pershtatur me ndryshimet dhe nevojat e tregut, brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;
- iii) Sipërmarrësi Altelecom Sh.a., të publikojë marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe Tregues Kryesore të Performancës (Key Performance Indicators -KPI) për interkoneksionin sipas përcaktimeve të Rregullores së Akses dhe Interkoneksionit.

3.2 **Detyrimi i transparencës:**

Oferta Referencë e Interkoneksionit e përditesuar nga Altelecom duhet të përshijë informacionin e mëposhtëm të nevojshme për interkoneksion me Altelecom:

- a) Specifikimet teknike;
- b) Karakteristikat e rrjetit;
- c) Termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- ç) Tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme.

3.3 **Detyrimi per akses dhe interkoneksion dhe perdorimi i perbashket i faciliteve te rrjetit:**

Sipërmarrësi Altelecom Sh.a., për terminimin e thirrjeve në rrjetin celular, duhet:

- a) te interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit dhe të ofrojë akses në shërbimet shoqëruese;
- b) te ofrojë shërbime te veçanta ne nivel shumice, per t'u rishitur nga palet e treta;
- c) te mos anulojë aksesin ne facilitetet, kur e ka dhene ate;
- ç) te negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- d) te ofrojë akses te hapur ne nderfaqet teknike, protokollet ose teknologjite e tjera te rendesishme, te domosdoshme per nderveprimin e shërbimeve ose per shërbimet e rrjetit virtual;
- dh) te ofrojë bashkevendosje ose forma te tjera te perdorimit te perbashket, përfshire nderatesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;
- e) te krijojë kushtet e nevojshme per te siguruar nderveprimin e shërbimeve pike fundore – pike fundore, duke përfshirë facilitetet per shërbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose roaming-ut ne rrjetet mobile;

ë) te ofroje akses ne sistemet mbeshtetese funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (softëare), te nevojshme, per te siguruar konkurrence te ndershme ne ofrimin e sherbimeve;

Për gërmat d), dh), e), ë), të mësipërme, detyrimi për akses i referohet vetëm për mundësimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Albtelecom, dhe janë të zbatueshme sipas mundësive/aftësive teknike dhe ekonomike të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a, si edhe me tarifa të cilat mbajnë parasysh investimet e kryera dhe një normë të arsyeshme fitimi.

3.4 Detyrimi për kontroll të tarifave, për ndarjen e llogarive dhe sistemin e mbajtjes së llogarive:

- i) Tarifa e terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me terminimin e thirrjeve në rrjetin Albtelecom janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.
- ii) Në përputhje me nenin 57, pika 1 gërma ‘a’, Vlerat maksimale të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të Albtelecom, për t’u aplikuar nga Albtelecom sh.a të jenë sipas vlerave dhe afateve të përcaktuar në Tabelën 1, më poshtë:

TABELA 1: VLERAT MAKSIMALE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETIN CELULAR ALBTELECOM

	1.04.2014- 30.11.2014	1.12.2014- (deri ne nje vendim tjetër te AKEP)
Tarifa e terminimit të thirrjeve	4.00	1.48

Shenim: Vlerat ne lek/minute pa TVSH

- iii) Zbatimi i detyrimit të ndarjes së llogarive dhe mbajtjes së llogarive (nenet 41 dhe 45) nga Albtelecom, të kryhet në bazë të përcaktimeve të Rregullores “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”, miratuar me Vendim të KD të AKEP Nr. 2406, datë 26.12.2013
4. Sipërmarrësi Albtelecom Sh.a. për statusin me FNT për terminimin e thirrjeve, bazuar në detyrimin e mosdiskriminimit (neni 39 i ligjit 9918 dhe pika 3.1 më sipër), si dhe në bazë të nenit 51 të ligjit 9918 ka edhe detyrimet e mëposhtëme:
- 4.1 Sipërmarrësi Albtelecom Sh.a ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare:
- (1) tarifat e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare nuk duhet të jenë më të larta se tarifat e thirrjeve brenda rrjetit Albtelecom;
 - (2) Sasia e minutave brenda rrjetit Albtelecom të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;
 - (3) Përcaktimet e pikave 1 dhe 2 më sipër aplikohen për të gjitha paketat tarifore standarte, ofertat, shportat, opsionet dhe skontot të ofruara për pajtimtarët;

4.2 Siper marrësi Albtelecom Sh.a për paketat tarifore standarde dhe ofertat/promocionet apo skontot e perkohshme ne teresi të ofruara për pajtimtarët e shërbimit celular ka detyrim:

- (1) ne muajin Janar te cdo viti te paraqese ne AKEP tarifate e planeve standarde dhe ndryshimet e kryera ne vitin paraardhes;
- (2) Ofertat/promocionet apo skontot e perkohshme ne teresi:
 - a. duhet te kene afat vlefshmerie te percaktuar qarte qe ne fillim te aplikimit dhe jo me te gjate se 3 muaj.
 - b. qe zgjasin me shume se 3 muaj duhet te perfshihen ne paketat/tarifate standarde;
 - c. nuk duhet të ri-hidhen në treg me emër të ndryshuar kur elementët kryesorë të tyre janë thelbësiht të pandryshuar apo të ngjashëm;

4.3 Afati i fillimit të zbatimit të detyrimeve të pikave 4.1 dhe 4.2 është data 1.01.2015.

5. Siper marrësi Albtelecom Sh.a ka detyrimin që të zbatojë detyrime dhe specifikime të tjera të përcaktuara nga AKEP, sipas nevojave te tregut, per statusin e FNT në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve.
6. Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT për siper marrësin Albtelecom Sh.a. në tregun përkatës referuar në pikën 1 të këtij vendimi, është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut te kryer sipas nenit 34 te Ligjit 9918.
7. Dokumenti “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumice të terminimit dhe tregu me pakice i shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme - Dokumenti Përfundimtar*”, miratuar me VKD Nr.2522, datë 6.11.2014, është pjesë arsytuese e këtij vendimi.
8. Vendimi nr.2120, datë 4.07.2012 i Keshillit Drejtues të AKEP shfuqizohet.
9. Kundra ketij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës.
10. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.
Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE